REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 71/17
Datë/Datum 24.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Komuna Kamenicë".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr. 71/17.**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Hartimi i hartës Zonale të Komunës"**, me nr. të Prokurimit: KM **653/16/019/221.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE Instituti për shkencë dhe teknologji "Insi" sh.p.k - Prishtinë**		
Datë	**24.03.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesen e parashtruar nga OE "Insi"sh.p.k - Prishtine, kundër AK-së, **Komuna Kamenicë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Hartimi i hartës zonale të Komunës"** me nr. të Prokurimit: **KM 653/ 16/019/221.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

		17.03.2017		**21.03.2017**		**24.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 10.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **71/17,** e parashtruar nga OE "Insi"sh.p.k - me seli në Prishtine, lidhur me aktivitetin të prokurimit "**Hartimi i hartës zonale të Komunës"** me nr. të Prokurimit: **KM 653/16/019/221**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Kamenicë.**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna e Kamenicës.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "INSI" sh.p.k me seli në Prishtine.

- Autorieti Kontratkues me rastin e vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave, ka shkelur dispozitat e Ligjit të prokurimit publik, **Neni 59**, duke mos bërë vlerësim objektiv për këtë procedurë.
- Në bazë të të dhënave të cilat i posedojmë, edhe operatori ekonomik Visioni Projekt, menaxherin e kontratës Shkëlqim Osmani, e ka përfshirë në listen e stafit, ashtu siq ka vepruar OE "INSI".
- Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) për një veprim të tillë në vendimin nr.475/16 të datës 09.02.2017 (shih vendimin e bashkangjitur), vlerëson se operatori ekonomik INSI është i papërgjegjshëm sepse ka vepruar jo në pajtim me kërkesat e Autoritetit Kontraktues, duke potencuar se (citojmë) "emrin e menaxherit e ka vendosur edhe te lista e inxhinjerëve tjerë, e që normalisht në bazë të kërkeses është dashur që në atë listë të vendosen emrat e inxhinjerëve të tjerë të kualifikuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë" (mbaron citati), atëherë e njëjta gjë është dashur të të vlejë edhe për operatorin ekonomik Vision Projket. Vlersojmë se edhe OSHP, ashtu sikurse edhe Autoritetit Kontraktutes, nuk i ka trajtuar operatorët ekonomik në pajtim me Nenin 7 të LPP:

  Neni 7 i LPP-së: Barazia në trajtim/ Jo Diskriminim: citojmë:

  1. Autoriteti Kontrakutes do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
  2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekomomik.

Pas qasjes në dokumentacion për këtë lëndë, kemi parë se edhe anëtarët e Komisionit të vlerësimit e kanë theksuar këtë shqetësim se të dy operatoret ekonomik e kanë të njëjtin lëshim në përmbushje të kërkesës për aftesitë teknike dhe profesionale, por Autoriteti kontraktues nuk i ka marrë parasysh mospajtimet e tyre të bazuara në fakte. (shih faksimilet e bashkangjitura).

Autoriteti kontraktues Komuna e Kamenicës, bie edhe në kundërshtim me Vendimin e OSHP-së, pasi që operatorin ekonomik INSI e vlerëson të papërgjegjshëm (shih letrën standarde për operatorin ekonomik të pasuksesshëm), vetëm e vetëm që të ketë arsye që edhe operatorin ekonomik "Vision Projkt" ta shpallë të përgjegjshëm, duke ditur se ai kishte ofruar çmim më të ulët dhe kështu do të "Plotesoheshin" kushtet për ta përzgjedhur fitus, në vend se në këtë rast të korrigjonte lëshimin (teknik) favorizues të OSHP-së të bërë ndaj operatorit ekonomik "Vision Projekt". Pasi që AK-ja mbetet edhe më tej në qëndrimet e saj (shih vendimin për refuzim të kërkesës për Rishqyrtim), ne parashtruam këtë ankesë në OSHP, por edhe do t'i njoftojmë organet tjera të cilat do të merren lidhur me shkeljet e bëra nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Kamenicës.
Me këtë rast kërkojm Organi Shqyrtues i Prokurimit të urdhëroj Autoritetin Kontrakutes Komuna e Kamenicës, që të bëjë anulimin e procedurës, duke u bazuar në gjendjen faktike të ofertave, e jo një operator ekonomik ta favorizojë, ndërsa tjetrin ta ndeshkojë padrejtësisht, siq ka vepruar në këtë rast.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- Vendimi i AK Komuna e Kamenicës për refuzim të kërkesës për Rishqyrtim
- Kërkesa për Rishqyrtim
- Vendimi i OSHP-së
- Letra e antarëve të Komisionit të vlerësimit
- Kopejt e ofertës së OE "Vision Projekt", lista e stafit dhe caktimi i Menaxherit.

Demi Material:

- Me këtë veprim Autoriteti Kontrakutes na ka shkaktuar dëme materiale për angazhim të stafit në përgaditje të ofertës, angazhim të ekspertëve në analiza të ndryshme.

Po ashtu dyshojmë se metodologjia e Punës, Plani dinamik dhe pjesa më e madhe e punës për Fazën e dytë të cilat ishin pjesë e tenderit tonë, mund të shfrytëzohen nga të tjerë operatorë ekonomikë, duke na shkaktuar dëme materiale dhe dëme në konkurrencën e mëtejme për projekte të kësaj natyre.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 12.08.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: ..... Shërbime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas zgjatjes se afatit,.....01.09.2016
Data e hapjes së ofertave:.....01.09.2016, ora 14:30
Njoftimi për dhënien e kontratës, hera II:.....01.03.2017
Kriter i dhënies së kontrates:.....Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët

Kriteret për vlerësim:

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:
Kërkesa 1 - Deklarata nën betim , neni 65 LPP/ 04-L042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237,*ligji Nr.05L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092.*
Kërkesa 2- Një vërtetim i lëshuar nga Gjykata kompetente apo Autoritetet Administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor gjatë 10 viteve të fundit sipas kërkesave të nenit 65 të LPP-së apo gjatë 2 viteve të fundit nuk është shpallur nga një

gjykatë si i falëmentuar.
Kërkesa 3- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) i tatimit së paku deri në 3 mujorin e vitit të fundit të datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1 – Një deklaratë e shkruar nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Evidenca për fituesin e tenderit para nënshkrimit të kontratës:
Evidenca 2 – Një vërtetim i lëshuar nga Gjykata kompetente apo Autoritetet Administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se ndaj operatorit ekonomiknuk është shpallur fajtor gjatë 10 viteve të fundit sipas kërkesave të nenit 65 të LPP-së apo gjatë 2 viteve të fundit nuk është shpallur nga një gjykatë si i falëmentuar,(origjinal ose kopje e noterizuar) vlen vetem për fituesin e tenderit.
Evidenca 3 – Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) i tatimit së paku deri në 3 mujorin e vitit të fundit të publikimit të Njoftimit të Kontratës .(vlen vetem për fituesin e tenderit)

Nëse operatori ekonomikfitues dështon në dorëzimin e këtyre dëshmive oferta në fjalë do të refuzohet.

III.2.2)<u>Përshtatshmëria profesionale:</u>

Kërkesa 1 - Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin tuaj të themelimit.
Kërkesa 2- Certifikata e Numrit Fiskal.
Kërkesa 3–Certifikata për Regjistrim të TVSH-së.
<u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u>
Evidenca 1 – Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (kopja e certifikatës së biznesit);
Evidenca 2 – Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal
Evidenca 3 – Kopja e Certifikatës së TVSH-së

III.2.3)<u>Kapaciteti ekonomik dhe financiar-</u>
Kërkesa 1 - Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i operatorit ekonomik, gjatë 3 viteve të fundit(2013-2014-2015) ka qenë jo më pak se 120,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1 – Pasqyra financiare e vertetuar në ATK.

1.III.2.4)<u>Kapaciteti teknik dhe profesional</u>
<u>Kërkesat:</u>

1. Operatori ekonomik duhet të ofroj listen e së paku njëprojekti për shërbime të natyrës së ngjashme të argumentuar me referencë në 3 (tri) vitet e fundit (2013, 2014, 2015).Lista duhet të paraqes:
   - Datën e realizimit
   - Llojin e shërbimeve të përfshira

- Pranuesin e shërbimeve dhe
- Shumën e kontratës

2. **Lista e Stafit proferional:**

a. Menaxher i Projektit- (minimum 5 vjet përvojë profesionale në planifikim dhe urbanizëm si dhe e të paktën tri projekte të ngjashëme në të kaluarën.
b. Një Inxhinier i ndërtimit- konstruktiv
c. Një inxhinier i Arkitekturës
d. Një inxhinier i hidroteknikes
e. Një inxhinier i elektroteknikës
f. Një Ekonomist i diplomuar
g. Një jurist i diplomuar
h. Një njohes i mire i programit të GIS-it
i. Një inxhinier i bujqësisë
j. Ekspert i vlersimit te mjedisit i licencuar

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e projekteve për shërbime të ngjashme(periudha 2013,2014 dhe 2015) të nënshkruara dhe vulosura

2. Kualifikimet arsimore dhe profesionale të personave që janë drejtpërdrejt përgjegjës për dhënien e shërbimeve këshilluese:

a. Deklaratë me shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit-Origjinali, Kopja e 3- referencave
b. Një Inxhinier i ndërtimit- konstruktiv (diploma kopje e vertetuar, kontrata e punes e nenshkruar dhe e vulosur- (deshmi mbi përvojën e punes min. 3 vite e nenshkruar dhe e vulosur)
c. Një inxhinier i Arkitekturës (diploma kopje e vertetuar, kontrata e punes e nenshkruar dhe e vulosur (deshmi mbi përvojën e punes min.2 vite e nenshkruar dhe e vulosur)
d. Një inxhinier i hidroteknikes (diploma kopje e vertetuar, kontrata e punes e nenshkruar dhe e vulosur (deshmi mbi përvojën e punes min.2vite e nenshkruar dhe e vulosur)
e. Një inxhinier i elektroteknikës (diploma kopje e vertetuar, kontrata e punes e nenshkruar dhe e vulosur (deshmi mbi përvojën e punes min.2 vite e nenshkruar dhe e vulosur)
f. Një ekonomist i diplomuar (diploma kopje e vertetuar, kontrata e punes e nenshkruar dhe e vulosur) (deshmi mbi përvojën e punes min.3 vite e nenshkruar dhe e vulosur)
g. Një jurist i diplomuar (diploma kopje e vertetuar, kontrata e punes e nenshkruar dhe e vulosur) (deshmi mbi përvojën e punes min.3 vite e nenshkruar dhe e vulosur)
h. Një njohës i mire i programit të GIS-it (Kopja e çertifikatës për GIS dhe deshmi mbi përvojën e punes min. 3 vite e nenshkruar dhe e vulosur)
i. Një inxhinier i bujqësisë (diploma kopje e vertetuar, kontrata e punes e nenshkruar dhe e vulosur (deshmi mbi përvojën e punes min.3 vite e nenshkruar dhe e vulosur)

Ekspert i vlersimit te mjedisit i licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapsinor (kopja e vertetuar).

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €
1.	"Inisi" shpk	Prishtinë	57,900.00 €
2.	"Infratek"	Prishtinë	46,787.00 €
3.	NNSH "Vision Projekt"	Prishtinë	47,198.82 €

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 01.09.2016, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë tre (3) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Raporti i Komisionit të vlerësimit:

Përbërja e komisionit vlerësues:
Nexhat REXHEPAJ – Kryesues,
Ahmet Malsiu – anëtar,
Jakup Cakolli – anëtar,
Komisioni vlerësues ka përfunduar raportin e vlerësimit me datë 24.02.2017.

Komisioni vlerësimit, pas ri-vlerësimit deklarojm se nga tre ofertuesit që kan dorëzuar ofertat e tyre dy i plotësojne kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit oferta e OE Vision project dhe OE Insi, janë oferta të përgjegjshme .
Pasi që oferta e OE Vision project, është me çmim më të ulët, komisioni rekomandon për shpërblim me kontratë.

Jakup Cakolli – anëtar i komisionit vlerësues, unë si anëtar i komisionit për ri-vlerësim të tenderit kam vërtetuar në dokumentacionin se faktet e lartcekura nga OSHP-ja , për OE Insi sh.p.k, janë të vërteta, mirëpo të njëjtat fakte i kamë gjetur edhe tek OE Vision project, andaj unë si anëtar i komisionit konstatoj se:
Pasi që të dy ofertat nuk i plotësojn kushtet e cekura në specifikim teknik të Tenderit (pika 2, lista e stafit profesional duhet që OE ti kenë 10 punëtor profesional sipas renditjes nga shkronja a) deri në f), ku ju mungojn inxhinjerat e arkitektures, sipas shkronjes c), andaj une si anëtar i komisionit REKOMANDOJ që tenderit të ANULOHET sepse të dy OE janë të papërgjegjshëm për arsyet e lartë cekura.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues:(N. 306) :

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, me vlerë të mesme, kontratë për shërbime, dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.
Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se, sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve, të datës: 01.09.2016, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë tre (3) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi, ndërsa **vërejtje nuk ka pasur.**
Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së,dhe nga përfaqësuesit e operatorëve ekonomik.

Eksperti Shqyrtues, gjatë analizimit dhe shqyrtimit të dosjes së tenderit konstaton se autoriteti kontraktues në raportin e ri-vlerësimit të ofertave të datës 24.02.2017, nga tri oferta pjesëmarrëse ne këtë aktivitet te prokurimit, vetëm një OE pjesëmarrës është shpallur i përgjegjshme, ofertë e cila rekomandohet për kontratë.

Pretendimi ankimor nr.1
Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket menaxherit të projektit dhe inxhinierit të artitektures, vlerëson se i njëjti pretendim ankimor për të njëjtin aktivitet të prokurimit është shqyrtuar me vendim nr.475/16 të dt.09.02.2017, Autoriteti kontraktues ka qenë i obliguar që gjatë re-vlerësimit të vlerësoj ofertat në harmoni me kriterin e FDT, duke i trajtuar në harmoni me nenin 7 dhe 59 të LPP-së, në lidhje me këtë pike.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e dosjes së tenderit është kërkuar shumë qartë menaxheri projektit të caktohet një inxhinier me përvojë punë 5 vite profesionale në planifikim dhe urbanizem, si dhe inxhinieret sipas profesionit: inxh. Ndërtimit konstruktiv, inxhi. Artitektures, inxh. Hidroteknikes, inxhi. Elektroteknikes, e të tjerë, duke u bazuar në kërkesën e FDT-së. Eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar per kontrat ka ofruar listen e inxhiniereve ku ka caktuar te njëjtin inxhinier menaxheri i projektit si dhe inxhinier i artitektures, dhe i njëjti menaxheri i projektit NUK mundet të ushtroj detyren e inxhinierit të artitektures pasi që si kërkes e dosjes së tenderit është e ndarë , njëherit qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë i parashtruar nga ana e OE ankues.

Mendimi i ekspertit:

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendon që Autoriteti Kontraktues – Komuna Kamenicë, për aktivitetin e prokurimit "Hartimi i hartës Zonale të Komunës" me nr. të Prokurimit: KM 653/16/019/221, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, konkretisht nenin 7 dhe 59 të LPP-së
Prandaj eksperti shqyrtues i REKOMANDON panelit shqyrtues që të APROVOJ si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri-tenderim nëse edhe më tutje ka interes AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit.